

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. PASHK GJACI

03/21/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 19.03.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Pashk Gjaci, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 21.03.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Pashk Gjaci, kryetar i Gjykatës së Rrethit Përmet.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues e kryesuar nga z. Olsi Komici, znj. Valbona Sanxhaktari relatore, z. Roland Ilia anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.